



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:039260

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05397041

KE.nr.158/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike të paditësit Louis Vuitton Malletier me seli në Francë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve "Vokshi & Lata", me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Samiri Company SH.P.K., me NUI: 811458646, me seli në rrugën Sheshin Bill Clinton, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.C. avokat nga Prishtina, me objekt kontesti Shkelje e markës tregtare, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me datë 14.02.2024, në prani të përfaqësuesit të palës paditëse dhe përfaqësuesit të palës së paditur, me datën 29.02.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpapia e paditësit Louis Vuitton Malletier dhe VËRTETOHET se i padituri Samiri Company SH.P.K., me datat 05.01.2022 dhe 19.04.2022 përmes importimit të 76 copë të çantave të dorës, ka shkelur markat tregtare të regjistruara të paditësit "Louis Vuitton Malletier".
- II. I NDALOHET të paditurit që në të ardhmen të ndërmarrë çfarëdo veprimi me të cilin mund të shkelen të drejtat e pronësisë intelektuale të paditësit në çfarëdo mënyre, përfshirë importimin që përmbajnë elemente identike apo të ngjajshme me markat tregtare të regjistruar të paditësit.
- III. OBLIGOHET i padituri që të ia kompensoj paditësit shumën prej 63.44 € (gjashtëdhjetë e tri euro e katërdhjetë e katër cent) në emër shpenzimeve për shkatërrimin e mallrave si në pikën I të dispozitivit, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbushjes së detyrueshme.

- IV. OBLIGOHET i padituri që ti ofroj paditësit informacionet për furnizuesin e huaj për mallrat e cekura si në pikën I të dispozitivit, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi
- V. OBLIGOHET i padituri që me shpenzime të tij ta publikoj këtë aktgjykim në dy medime të Republikës së Kosovës, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbushjes së detyrueshme.
- VI. REFUZOHET si e pa bazuar pjesa e kërkesëpadisë, me të cilën paditësi Louis Vuitton Malletier ka kërkuar që të detyrohet i padituri Samiri Company SH.P.K., që të ia paguaj shumën prej 10,000.00 €, në emër të gjobës për shkeljen e markës tregtare të paditësit në rastet e iniciuara nga Dogana e Kosovës sipas numrit 02-2022 dhe 165-2022.
- VII. DETYROHET i padituri që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 799.00 € (shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro), në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbushjes së detyrueshme.

### A r s y e t i m

Paditësi Louis Vuitton Malletier përmes të autorizuarit të tij, me datën 24.02.2023, ka paraqitur padi pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomave të Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, për shkelje të markës tregtare kundër të paditurit Samiri Company SH.P.K., me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit dhe të vërtetohet se i padituri ka shkelur markën tregtare të paditësit me numër regjistrimi 013193, 013194, 013195, 013197 dhe 026194; të i ndalohet të paditurit që në të ardhmen të importoj apo në çfarëdo forme të tregtoj mallra që shkelin markat tregtare të paditësit Louis Vuitton Malletier; të obligohet i padituri që paditësit të ia kompensoj të gjitha shpenzimet e shkatërrimit të mallrave për 2 rastet e iniciuara nga Dogana e Kosovës 02-2022 dhe 165-2022; të obligohet i padituri që të zbuloj informacionet për origjinën dhe shpërndarjen e produkteve të cilat shkelin markat tregtare të paditësit, siç janë informatat për emrat dhe adresat e prodhuesve, shpërndarësve, furnitorëve dhe pronarëve të tjerë të mëparshëm të produkteve, shitësve me shumicë dhe pakicë dhe informatat për sasinë e prodhuara, shpërndara, pranuar dhe të porositura si dhe çmimin për produktet; të obligohet i padituri që në emër të ndëshkimit për shkelje të

markës tregtare të paditësit të ia paguaj gjobën prej 5,000.00 €, për secilin rast apo shumën e përgjithshme në vlerë prej 10,000.00 €, sipas numrit të rastit 02-2022 dhe 165-2022; të obligohet i padituri që me shpenzimet e tij të publikoj në mjetet e informimit publik këtë aktgjykim si dhe të obligohet i padituri që paditësit të ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita kur vendimi të merr formën e prerë.

E autorizuar e paditësit gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë kërkesave të paraqitura me padi. Ka theksuar që i padituri në dy raste të specifikuar si në padi ka tentuar që të importoj produkte të llojeve të ndryshme në sasi të ndryshme të cilat i shkelin markat tregtare të paditësit e të cilat janë të regjistruara në API, duke theksuar se paditësi lidhur me tentimin e importimin e produkteve kontestuese është njoftuar nga Dogana e Kosovës përmes njoftimeve të datave 05.01.2022 dhe 19.04.2022.

Nga njoftimi i Doganës vërtetohet se i padituri në vazhdimësi i ka shkelur markat tregtare të paditësit meqenëse ndaj tij vetëm gjatë viti 2022 janë iniciuar dy raste nga Dogana e Kosovës lidhur me ndalimin e mallrave për shkak të dyshimit se të njëjtat shkelin markat tregtare të paditësit, duke theksuar që pas pranimit të njoftimit nga Dogana e Kosovës paditësi ka bërë verifikimin e mallrave dhe ka vërtetuar se mallrat e ndaluara nuk janë prodhuar nga paditësi dhe se i njëjti nuk ka dhënë as licencë për prodhimin e tyre. Në mallrat e ndaluara nga Dogana e Kosovës është evidente se janë përdorur markat tregtare të regjistruara të paditësit, andaj duke u bazuar në nenin 8 të LMT-së, paditësi ka kërkuar nga Gjykata që kërkesëpapia e paditësit të aprohet në tërësi si e bazuar.

Sa i përket pretendimeve të paditurit, paditësi të njëjtat i ka kundërshtuar në tërësi për faktin se nga Deklarata unike Doganore rezulton se kompania e të paditurës është importuese e mallrave kontestuese dhe jo vetëm transportuese siç ka pretenduar i padituri, ndërsa sa i përket pretendimit të të paditurit se në rastin konkret kemi të bëjmë me çështje të gjykuar ka theksuar se një pretendim i tillë është i pabazuar për faktin se gjobat të cilat e paditura thekson se i ka paguar janë shqiptuar nga Dogana e Kosovës dhe jo nga gjykata dhe në rastin konkret kjo çështje lidhur me këtë sasi të mallit të ndaluar nga Dogana dhe të shkatërruar nën mbikëqyrjen doganore po zhvillohet për herë të parë pranë kësaj gjykate. Po ashtu paditësi ka bërë precizimin e pikës III të kërkesëpadisë duke kërkuar nga Gjykata që i padituri të ia kompensoj paditësit shumën prej 63.44 €, në emër të shpenzimeve për shkatërrimin e mallrave. Në fund i ka propozuar

gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

I padituri në përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se e paditura nuk i ka dhënë shkas kësaj procedurë meqenëse të njëjtit janë pajtuar për shkatërrimin e mallit, gjë e cila ka ndodhur në prezencën edhe të paditurit, duke potencuar që në rastin konkret paditësit nuk i është shkaktuar asnjë dëm i vetëm. Më tutje i padituri ka theksuar që veprimtaria e tij ka të bëjë me transportimin e mallrave që nënkupton se e njëjta pranon mallin në depon e saj në Stamboll nga të gjithë importuesit sidomos të butiqeve dhe importuesve tjerë të cilët e blejnë mallin në Turqi dhe pasi që të bëjnë grumbullimin e këtij malli të njëjtin e ngarkojnë në kamion, ndërsa duke marr parasysh që i padituri e ka infrastrukturën e përgatitur për këtë biznes, i njëjti bën edhe përpilimin e dokumentacionit të transitit dhe importin për Republikën e Kosovës. Ka shtuar që e paditura importon mall me tonelata brenda vitit, si dhe bën kujdesin maksimal që në shumicën absolute të rasteve të mos ngarkoj mallra që i nënshtrohen të drejtave të markës tregtare ose janë që janë të ndaluara për import në Kosovë, mirëpo që në rastin konkret për shkak të volumit të madh të mallrave të cilat i importon i padituri, ka rezultuar që edhe malli kontestues është transportuar.

Më tutje ka theksuar që e paditura në momentin e pranimit të mallrave në Stamboll, i njofton të gjithë klientët e saj që në rast të futjes së mallrave të ndaluara për transportim, të njëjtat do të shkatërrohen, duke theksuar që për rastin konkret nuk ka pasur përjashtim dhe të njëjtit janë pajtuar që të bëhet shkatërrimi i këtyre mallrave. Lidhur me shpenzimet e kërkuara në vlerë prej 63.44 € i padituri ka theksuar se ky mall është shkatërruar nga punëtorët e kompanisë dhe jo nga ndonjë kompani e specializuar dhe kjo dëshmohet nga fotot e mallit të cilat janë të bashkëngjitur në lëndë e nga të cilat shihet se shkatërrimi është bërë me thika dhe jo në mënyrën profesionale siç bëjnë kompanitë e specializuara, andaj fakti që paditësit ka prezantuar fatura të përgjithshme nuk janë të mjaftueshme që të përcaktohet shpenzimi në rastin konkret. Në rastin konkret po të kishte faturë individuale paditësi ka qenë i detyruar që paraprakisht të ia dërgoj të paditurit për pagesë vullnetare.

I padituri po ashtu ka theksuar që në rastin konkret kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, meqenëse të paditurit lidhur me këtë çështje veçse i është shqiptuar gjobë nga ana e Doganës së Kosovës. Në fund ka theksuar që në rastin konkret, meqenëse nuk është shkaktuar asnjë dëm nga ana e tij, si dhe duke marr për bazë faktin që i padituri nuk i ka dhënë shkas padisë, i ka propozuar

gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Ekstrakti - vendimi për regjistrimin e markës tregtare Nr.013193, të datës 26.08.2014; Ekstrakti - vendimi për regjistrimin e markës tregtare Nr.013197, të datës 27.08.2014; Ekstrakti - vendimi për regjistrimin e markës tregtare Nr.013195, të datës 27.08.2014; Ekstrakti - vendimi për regjistrimin e markës tregtare Nr.013194, të datës 26.08.2014; Ekstrakti - vendimi për regjistrimin e markës tregtare Nr.026194, të datës 04.03.2020; Listë distribuimi – njoftim nga Dogana e Kosovës rasti 02-2022 Louis Vuitton, i datës 05.01.2022; Listë distribuimi – njoftim nga Dogana e Kosovës rasti 165-2022 Louis Vuitton, i datës 19.04.2022; Deklarata unike doganore R-53756, e datës 27.12.2021; Kërkesa për verifikimin të markave tregtare Nr.Prot.2021 25639/1, të datës 27.12.2021; Procesverbali mbi asgjësimin e mallrave Nr.2022 1583/1, i datës 26.01.2022; Shikimi i foto dokumentacionit në përbërje prej katër fotografive; Aktvendimi i lëshuar nga Dogana e Kosovës – 03.1.7-2022-134, i datës 28.01.2022; Deklarata unike doganore R-6800, e datës 16.04.2022; Procesverbali mbi asgjësimin e mallrave Nr. I rastit të DPI – 85-2022, i datës 14.06.2022; Aktvendimi i lëshuar nga Dogana e Kosovës – 03.1.7-2022-917, i datës 29.06.2022; Shikimi i foto dokumentacionit në përbërje prej dy fotografive; Fatura nr.005/22, e datës 06.06.2022 dhe fatura nr.006/22, e datës 21.06.2022.

Deklarimet e palëve ndërgjyqëse, si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas Ekstrakteve për vendimin për regjistrimin e markës tregtare Nr.013193, të datës 26.08.2014, vendimin për regjistrimin e markës tregtare Nr.013197, të datës 27.08.2014, vendimi për regjistrimin e markës tregtare Nr.013195, të datës 27.08.2014, vendimin për regjistrimin e markës tregtare Nr.013194, të datës 26.08.2014, vendimin për regjistrimin e markës tregtare Nr.026194, të datës 04.03.2020 vërtetohet se paditësi ka regjistruar dhe e ka vazhduar regjistrimin pranë Agjencisë së Pronësisë Industriale dhe është pronar i markave verbale tregtare me emrin “LOUIS VUITTON”, markës figurative me kombinimin e shkronjave “LV”, markës figurative të dizajnit në formën e luleve të cilat rrethojnë mbishkrimin e kombinuar

me shkronjat “LV”, markës figurative - dizajnin në kuadrate në formën e shahut me formulimin “LOUIS VUITTON PARIS”, si dhe është bartës i të drejtës së këtyre markave tregtare për produktet dhe shërbimet nga Klasa 3, 9, 14, 18, 24, 25, të Klasifikimit të Nicës.

Sipas Listës së distribuimit-njoftim nga Dogana e Kosovës rasti 02-2022 Louis Vuitton, të datës 05.01.2022 vërtetohet se 60 copë çanta dore janë ndaluar nga Dogana nën dyshimin për shkelje të se drejtës së markave tregtare të paditësit, ndërsa nga Lista e distribuimit-njoftim nga Dogana e Kosovës rasti 165-2022 Louis Vuitton, të datës 19.04.2022 vërtetohet se 16 copë çanta dore janë ndaluar nga Dogana nën dyshimin për shkelje të se drejtës së markave tregtare të paditësit.

Nga kërkesa për verifikimin të markave tregtare Nr.Prot.2021 25639/1, të datës 27.12.2021 të lëshuar nga ekipa e ekzaminimit ZBD Prishtina – 2, pranë Doganës së Kosovës rezulton se janë ndaluar për verifikim 60 copë çanta dore për femra nga skaji i markës “Louis Vuitton”, si dhe është dhënë pëlqimi për shkatërrimin e këtyre mallrave.

Nga procesverbali mbi asgjësimin e mallrave Nr.2022 1583/1, të datës 26.01.2022 si dhe nga shikimi i foto dokumentacionit rezulton se asgjësimi i mallit sipas DUD R – 53756 në sasi prej 60 copë çanta dore Louis Vuitton, është kryer në hapësirën e mbyllur me kamera në depon e ZBD Intereuropa.

Sipas Aktvendimit 03.1.7-2022-134 të datës 28.01.2022 të lëshuar nga Dogana e Kosovës – Sektori për kundërvajtje Doganore Prishtinë, subjekti juridik “Samiri Company” – SH.P.K., me NUI: 811458646 është shpallur përgjegjës dhe i është shqiptuar gjobë në vlerën prej 1,000.00 €, për shkak të kundërvajtjes doganore si pasojë e shkeljes së të drejtave të pronësisë intelektuale me rastin e gjetjes së mallit kontestues në sasi prej 60 copë çanta dore Louis Vuitton.

Nga Procesverbali mbi asgjësimin e mallrave Nr. i rastit të DPI – 85-2022, i datës 14.06.2022 si dhe nga shikimi i foto dokumentacionit rezulton se asgjësimi i mallit sipas DUD R – 6800 në sasi prej 16 copë çantë dore Louis Vuitton, është kryer në hapësirën e mbyllur me kamera në depon e ZBD Prishtina 3.

Sipas Aktvendimit – 03.1.7-2022-917, të datës 29.06.2022 të lëshuar nga Dogana e Kosovës, Sektori për kundërvajtje Doganore Prishtinë, subjekti juridik “Samiri Company” – SH.P.K., me NUI: 811458646 është shpallur përgjegjës dhe i është shqiptuar gjobë në vlerën prej 2,200.00 €, për shkak të kundërvajtjes doganore si pasojë e shkeljes së të drejtave të pronësisë intelektuale me rastin e gjetjes së mallit kontestues në sasi prej 16 copë çanta dore Louis Vuiton.

Nga Fatura nr.005/22 e datës 06.06.2022 dhe fatura nr.006/22 e datës 21.06.2022 rezulton se paditësi është faturuar në shumën prej 63.44 €, në emër të shpenzimeve për shkatërrimin e mallrave kontestuese.

Gjykata pas shqyrtimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, sepse shenja që është përdorur në produktet e të paditurit është identike me markën tregtare të paditësit dhe se në rastin konkret shenjat e përdorura në mallrat e të paditurit nuk ka asnjë dyshim se mund të shkaktojnë konfuzion në publik dhe secili konsumator do të krijoj bindjen se bëhet fjalë për produktet e paditësit.

Sipas Nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-026 Për Markat Tregtare (LMT) i aplikueshëm në rastin konkret, të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullar i markës tregtare mund të ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjën identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Me regjistrimin e një marke të caktuar, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare.

Bartësi i markës së regjistruar tregtare gëzon një numër të drejtash me regjistrimin e markës tregtare. Sipas LMT, bartësi i markës së regjistruar tregtare ka drejta të: ndalojë përdorimin e paautorizuar të markës tregtare të tij përmes mjeteve juridike në dispozicion (Nenet 8 – 13 i LMT); të përdorë markën e regjistruar në tregun e Kosovës (Neni 14 i LMT), si dhe të disponojë me markën tregtare të tij (Nenet 15 – 22 i LMT).

Mbajtësi i një marke tregtare sipas Nenit 8 të LMT-së, ka të drejtë të ndalojë: vendosjen e markës së mbrojtur, në mallra, në paketim ose etiketat e mallit; ofrimin e mallrave, vendosjen e tij në treg apo ruajtjen e saj për këto qëllime, apo ofrimin e shërbimeve nën markën tregtare të

tij; importimin, eksportimin ose transitin e mallrave nën markën tregtare dhe përdorimin e markës së mbrojtur në dokumentet zyrtare ose për reklama.

Përdorimi i paautorizuar i një marke tregtare, si e drejtë ekskluzive e pronarit të saj, përbën shkelje të markës tregtare. Sipas Nenit 8 të LMT-së, shkelja mund të bëhet me çdo veprim të ndërmarrë pa autorizimin e pronarit, me të cilin atakohet të paktën njërën prej të drejtave të pronarit të markës tregtare. Kjo shkelje mund të bëhet gjatë kohës së vlefshmërisë së markës tregtare, brenda territorit për të cilën ajo është e autorizuar.

Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës dhe deklaratimet e palëve ndërgjyqëse rezulton si jokontestues fakti se i padituri ka importuar mallrat kontestuese pa autorizimin e paditësit si bartës i të drejtave nga marka tregtare e regjistruar “Louis Vuitton Malletier”. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, fakti se mallrat janë asgjësuar me pëlqimin e të paditurit nuk mund ta përjashtoj nga përgjegjësia të paditurin dhe bazuar në dispozitat e sipërcituara vetëm fakti i importimit të mallrave në tregun përkatës, pa autorizimin e bartësit të së drejtës së markës tregtare të regjistruar, përbën shkelje të markës tregtare.

Prandaj duke u nisur nga të sipër cekurat dhe nga fakti se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, gjykata ka konstatuar se i padituri përmes vënies në qarkullim të produkteve me shenjat “Louis Vuitton Malletier”, ka shkelur markën tregtare të paditëses.

Gjykata vlerësoi edhe deklaratat unike doganore të dorëzuara nga i padituri mirëpo gjeti se të njëjtat nuk kanë ndikim për vendosje në këtë çështje kontestimore për faktin që edhe nga vet i padituri nuk kontestohet se i njëjti me rastin e importimit të mallrave të lartcekura ka shkelur markat tregtare të paditësit.

Gjykata po ashtu ka refuzuar propozimin e të paditurës për marrjen e incizimeve nga Dogana e Kosovës për arsye se nga procesverbalet për shkatërrimin e mallrave dhe foto dokumentacioni në shkresat e lëndës në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike lidhur me procedurën e zhvilluar për shkatërrimin e mallrave kontestuese.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimin e të paditurit se në rastin konkret kërkesa e paditësit, përbën çështje të gjykuar, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pabazuar, meqenëse objekt



i shqyrtimit në këtë çështje juridike ishte kërkesa e paditësit për vërtetimin e shkeljes së markës tregtare, ndërsa sipas aktvendimeve të lëshuara nga Dogana e Kosovës, rezulton se të paditurit vetëm i është shqiptuar gjoba për importimin e mallrave kontestuese të lartcekura.

Gjykata ka vendosur sikurse në pikën VI të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit, me të cilën paditësi ka kërkuar që të detyrohet i padituri që të ia paguaj shumën prej 10,000.00 €, në emër të gjobës për shkeljen e markës tregtare të paditësit në rastet e iniciuara nga Dogana e Kosovës sipas numrit 02-2022 dhe 165-2022, për faktin se në rastin konkret paditësit nuk i është shkaktuar dëm, meqenëse mallrat kontestuese të paditurit të cilat kanë shkelur markat tregtare të paditësit veçse janë ndaluar dhe janë shkatërruar nga ana e Doganës, me pëlqimin e të paditurit. Andaj gjykata vlerëson se në rastin konkret shqiptimi i gjobës edhe nga ana e Gjykatës për të paditurin është i pabazuar edhe për faktin se në rastin konkret të paditurit për veprimet e tij veçse i është shqiptuar gjobë kundërvajtëse nga ana e Doganës në shumën e përgjithshme prej 3,200.00 €.

Vendimin për publikimin e këtij aktgjykimi, si dhe vendimin për dhënien e informacioneve, gjykata e morri konform dispozitave të nenit 99 dhe 100 të Ligjit Nr.04/L-026 për Markat Tregtare dhe nenit 30 të Ligjit Nr. 05/L – 040 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-026 për Markat Tregtare.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën VII të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi me zbatimin e rritjes prej 100% për shkak të kontestit me element të huaj sipas tarifës së OAK dhe atë: për përpilimin e padisë në shumën prej 208.00 €, për taksën gjyqësore për paraqitjen e padisë shumën prej 51.00 €, për përfaqësim në seanca 540.00 €, (2x270 €), gjithsej shumën prej 799.00 €.

Nga arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.158/23, datë 14.02.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.